



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A

DREJTORIA E MARKETINGUT
SEKTORI I FILATELISË DHE PULLËS

Kriteret e konkurimit për përgatitjen e bocetave të emisioneve të pullave postare shqiptare që do të emetohen gjatë vitit 2025

1. Në zbatim të nenit Nr. 18 të VKM Nr. 1039 datë 16.12.2015 “Për Përcaktimin e Procedurave Për Emetimin, Prodhimin, Përdorimin dhe Tregtimin e Pullës Postare Shqiptare”, ju njohim me kriteret e pjesëmarrjes në konkursin për bocetat e emisioneve të pullave që do të emetohen gjatë vitit 2023.
2. **Kriteret duhen zbatuar në çdo pikë.**
3. Bocetet e emisionit do të përmbajnë bocetet e pullave dhe bllokut kur ka, bocetin e zarfit të ditës së parë dhe bocetin e vulës së ditës së parë.
4. Bocetet duhet të jenë o në vertikale o në horizontale jo dy llojesh brenda një emisioni.
5. Tema dhe nën tema duhen shkruar në mënyrë të saktë mbi bocet në kompjuter siç ju është dhënë.
6. Vlerat e lekëve mbi pulla vendosini provizore për arsye kompozimi.
7. Fjala **SHQIPËRIA** duhet të jetë me shkronja të mëdha
8. Bocetet e punuara me dorë duhet të skanohen me resolution të lartë rreth **1200 dpi** në mënyrë që kur të punohen në kompjuter të paraqesin maksimalisht punimin me dorë. Bocetet e paraqitura me foto duhet gjithashtu të kenë resolution të lartë fotot.
9. Bocetet e punuara me dorë duhet të paraqiten së bashku me punimin e bocetit të punuar në kompjuter.

10. Pullat duhet të punohen në kompjuter me programin vektorial Adobe Illustrator.

11. Në punimin e bocetit me kompjuter duhet respektuar saktësisht formati i pullës siç ju është dhënë dhe shkrimet (tema, nëntema, vlera në lekë dhe SHQIPËRIA) të jenë larg 2,5 mm brenda përmasave. Kjo për arsye të birosjes sepse mund të çënojë kompozimin.

12. Bocetet për çdo pullë të emisionit duhet të printohen në format A4, si dhe në një A4 duhet printuar emisioni komplet me pullat, zarfin dhe vulën e ditës së parë në format real, **Bocetet dhe printimet duhet të jenë pa emrin e autorit, modelet si më poshtë :**




A4 printim

Elementët e pullës postare shqiptare



- Paraqitja në konkurs për bocetat e emisioneve të pullës pranë komisionit shtetëror të pullës postare shqiptare bëhet sipas formatit të më poshtëm:



- Në rast se autori shënon emrin dhe mbiemrin mbi bocete të punuara me dorë dhe printime do ti jepen mbrapsht për ti korigjuar dhe riprintuar.
- Çdo emision duhet të futet në zarf më vete ku të shkruhet vetëm tema **jo emri i autorit**
- I gjithë materiali kompjuterik së bashku me fontet që janë përdorur për shkrimet do të futet në një CD që do të dorëzohet së bashku me bocetet origjinale dhe të printuara sic u tha më sipër, **emri dhe mbiemri i saktë i autorit do të shënohen vetëm mbi CD.**
- Në zbatim të pikës 2 të nenit Nr. 19 të VKM Nr. 1039 datë 16.12.2015 “Për Përcaktimin e Procedurave Për Emetimin, Prodhimin, Përdorimin dhe Tregtimin e Pullës Postare Shqiptare”, konkuruesi duhet të paraqesë dhe deklaratën që punimi është origjinal dhe nuk shkel të drejtat e autorit.
- Në zbatim të nenit Nr. 20 të VKM Nr. 1039 datë 16.12.2015 “Për Përcaktimin e Procedurave Për Emetimin, Prodhimin, Përdorimin dhe Tregtimin e Pullës Postare Shqiptare”, punimet do të dorëzohen nga konkuruesi pranë protokollit në Drejtorinë e

Përgjithshme të Postës Shqiptare ku do të rregjistrohen dhe do të hapen vetëm në prezencë të Komisionit Shtetëror të Pullës Postare Shqiptare.

18. Afati i dorëzimit të bocetave për tematikat e pulles 2025 është 1 shtator 2023.

19. Për çdo informacion tjetër të nevojshëm nga ana juaj kontaktoni në e-mailin ana.zejnati@postashqiptare.al.

,